

UDHËZIM
Nr. 13, datë 6.5.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 32,
DATË 31.12.2013, “PËR TATIMIN E THJESHTUAR
MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 10 “Administrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, në fund të paragrafit të parë shtohet fjalia me përmbajtjen e mëposhtme:

“Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT-ja regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 “Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim” me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë”.

2. Në pikën 11 “Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore”, në germen “c” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në aktrakordimin e hartuar në

tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara.

Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të aktrakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale “Tatime me deklaram”, në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës.

Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të aktrakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të aktrakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 “Transferta në institucionet nacionale” në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 “Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale.”.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCEVE
Shkëlqim Cani

AKT-RAKORDIMI

I mbajtur në datën _____, midis Drejtorisë Rajonale Tatimore _____ dhe komunës/bashkisë _____, lidhur me totalin e shumës së arkëtuar, nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në llogarinë përkatëse të DRT-së, për periudhën nga data _____ deri në datën _____

Lloji i taksës	Emri i komunës/bashkisë	Llogaria kontabile (ku kanë kaluar arkëtimet)	Muaji në të cilin janë bërë arkëtimet	Shuma e arkëtuar gjithsej (në lekë)	Shuma e të ardhurave për komunën/bashkinë (99% e totalit)	Shuma e të ardhurave që i takon DRT-së (1% e totalit)
1	2	3	4	5	6=5 x 99%	7 = 5 x 1%
Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël		4481100	01 deri 00/00/2014			

Shënim. Akt-rakordimi përpilohet në tri kopje. Akt-rakordimit i bashkëngjitet lista e tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët. Shuma totale e tatimit të arkëtuar (shuma në kolonën 5) duhet të jetë e barabartë me shumën totale të listës (sipas udhëzimit nr. 32, datë 31.12.2013) bashkëngjitur akt-rakordimit.

Për komunën/bashkinë _____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)

Për Drejtorinë Rajonale Tatimore _____
Nëpunësi zbatues (emër, mbiemër)
Nëpunësi autorizues (emër, mbiemër)

KËRKESË

Shtetasja Ruzhdiye Kasapi, e bija e Halimit dhe e Nezires, lindur dhe banuese në Lushnjë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë shpalljen të vdekur të djalit të saj, shtetasit Marjus Kasapi, i datëlindjes 25.11.1987.

KËRKUESI
Ruzhdiye Kasapi